

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt.25 Gusht 2020 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

**PANDO PAPUÇI**, i biri i Nikolla, i datelindjes 16/02/1956, i lindur ne Malcan,Sarande dhe banues ne Sarande, lagjia Nr 1,Rr.Lefter Talo, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per tē vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes nderkombetare me nr. BD4678797 ,leshuar nga MB me date 21/06/2016,i cili me vullnet tē lire tē plete e tē singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perqejgjesi tē kufizuar, me emertimin **2P-SJ shpk**.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

#### Neni 1

##### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi tē kufizuar është **2P-SJ shpk**. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

#### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria **2P-SJ** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me përgjegjësi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi tē jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi tē ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj tē tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **2P-SJ** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit tē tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

##### Selia

##### Shoqeria e ka seline ne adresen:


**Lagj.Nr.1,Rruga Skandrbeu, pasuria me nr.27/211,zona kadastrale 8642 Sarande, Shqiperi.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarise

- Ndertime te objekteve civile dhe industriale.Projektimi dhe zbatimi per ndertimin e objekteve te ndryshme si dhe te ndertimeve civile industriale, turistike,bujqesore dhe kompletimi me instalime te nevojshme me tuba betoni si dhe ata elektrike, hidraulike, sistemeve te ngrohjes, ujsjellesa, kanalizime,hapje trasesh te te gjitha llojeve fushen e ndertimit, ndertim rrugesh,asfaltime etj. Sherbime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit.Prodhim i materialeve te ndryshme betoni.
- Perfaqesime kompanish te ndryshme nderkombetare,eskluzyivite apo ndermjetesime kompanish nderkombetare, ne fusha te prodhimit, tregtimit apo sherbimeve te ndryshme.
- Sherbime konsulence per investitoret,planifikimi, projektim dhe realizim i projekteve Industriale,Energjitime,Turistike e Bujqesore.



Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. **Z.PANDO PAPUÇI**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **100.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **100.000 Leke**, eshte paguar nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8  
Organji Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9  
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

Administrator i shoqerise eshte emeruar **PANDO PAPUÇI**, i biri i Nikolla, i datelindjes 16/02/1956, i lindur ne Malcan,Sarande dhe banues ne Sarande, lagjia Nr 1,Rr.Lefter Talo, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes nderkombetare me nr. BD4678797 ,leshuar nga MB me date 21/06/2016,Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.



The image shows a handwritten signature in black ink, which appears to be "Pando Papuci". Below the signature, the name is written in a smaller, printed font: "Pando Papuci".

Neni 10  
Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene a.Humbja e kapitalit ose pamundesa e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.  
b.Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 13  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te pote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permbytje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **2P-SJ shpk**, nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

Davallo Sofiemi

2010